


**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	09/03/2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Shef i Zyrës së Prokurimit në Qendrën Klinike Universitare
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtorit i Përgjithshëm i SHSKUK
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Furnizim me material hargjues për ortopedi"

I nderuara z. Rushiti,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "Furnizim me material hargjues për ortopedi" me numër prokurimi: 701 16 002 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshëm A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Furnizim me material hargjues për ortopedi" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, bazuar në nevojën e sajë për furnizim me material hargjues për ortopedi, ka paraparë procedurë të hapur për këtë aktivitet i cili është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 08/02/2016.

Në Njoftim për Kontratë në pikën III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional Autoriteti Kontraktues-QKUK ka kërkuar tek nënpika 4) : *Dëshmi se produktet e ofruara duhet të jenë të prodhuara ose të regjistruara në shtetet e BE (vendet e zonës shengen), SHBA, Zvicërr, Australi, Kanade, Turqi, Izrael, Japoni, Britani e Madhe.*

Autoritet Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë ka paracaktuar vendin e origjinës për materialet furnizuese. Me këtë veprim, ju si autoritet kontraktues favorizoni Operator të caktuar ekonomik dhe diskriminoni të tjerë. Nëse ju si Autoritet Kontraktues iu jeni referuar Udhëzuesit Administrativ për Produkte Medicinale i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, Agjencia nuk ka gjetur elemente që ky udhëzim e mbulon edhe furnizimin me material hargjues. Qendra Klinike Universitare e Kosovës, si Autoritet Kontraktues ka obligim ligjor që ti merr gjitha masat e duhura që në aktivitetet e prokurimit mos të ketë kritere jashtë kuadrit ligjor të prokurimit publik.

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se Njësia e Kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret e përzgjedhjes e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, ku përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuuese dhe njësisë së prokurimit, andaj secila duhet veproj komfor përgjegjësi që ka.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 9 Funksionet e njësisë së Kërkesës, Nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!